

Informatat mbi Projektin

Emri i Projektit:	Youth Career IT Pathway-YCIP
Vlera e projektit:	Shuma e përgjithëshme: € 170,515.18; Bashkëfinancimi (nëse ka) € 29,850.00
Kohëzgjatja:	Fillimi: 01/02/2018 Përfundimi: 31/12/2019
Organizata implementuese:	RIT Kosovo (A.U.K) College – Instituti për Trajnime dhe Zhvillim - TDI
Kontaktet e Organizatës: Adresa, e-maili, telefonat.	Rruga: Shpëtim Robaj p.n. 10000 Prishtinë +381(0)38 660 000/ +386(0)49774112 www.kosovo.rit.edu / auki@auk.org
Grupet e synuara:	200 të rinjë që janë të papunë ose të nën punësuar nga regjioni i Prishtinës, Ferizajt dhe Pejës
Partnerët:	N/A
Territori i synuar/shtrirja gjeografike:	Fokusi kryesor është në regjionin e Prishtinës, Ferizajt dhe Pejës, mirëpo të rinjtë nga regjionet e tjera që dëshirojnë dhe kualifikohen të marrin pjesë në trajnime në tri regjionet e caktuara nuk do të refuzohen.
Qëllimi i përgjithshëm:	Qëllimi i përgjithshëm i këtij projekti është trajnimi i 200 të rinjve të papunë ose të nën punësuar, nga regjioni i Prishtinës, Ferizajt dhe Pejës, të moshës 18-29 vjeç, me arsim para universitar, me qëllim të aftësisimit me shkathtësi të buta dhe teknike (p.sh. zhvillimi i Web & Mobile dhe IT teknik) për të marrë pjesë në tregun lokal të punës dhe për të konkurruar në ekonominë digjitale globale nëpërmjet punës përmes internetit (online work). Trajnimi do të rrisë mundësitë që të rinjtë të marrin pjesë në tregun e punës: në vend, duke lehtësuar tranzicionin e tyre përmes punës praktike dhe tregun ndërkombëtar përmes punës në internet.
Aktivitetet kryesore:	Kandidatet do të mbajnë 200 ore trajnimi; Zhvillim i aftësive të buta teknik dhe aftësi teknike, Mentorim, Vendosje praktike në tregun e brendshëm ose arritje në internet në ekonominë globale Certifikimi dhe Organizimi i panairit të punës në Prishtinë, Ferizaj dhe Pejë
Rezultatet e pritura:	Përmes ndërtimit të kapaciteteve njerëzore të 200 të rinjve të trajnuar do të zhvillohen dy lloje: shkathtësitë të transferueshme që janë të zbatueshme në të gjitha disiplinat siç janë aftësitë në gjuhën angleze, aftësitë e komunikimit, aftësia për të punuar në ekipe, aftësitë e të menduarit kritik, aftësia për të zgjidhur problemet dhe aftësinë për të aplikuar një punë (shkrim CV, intervistë, oferta në punë online, etj); dhe shkathtësitë teknike të lidhura me TIK , duke u fokusuar në punët më të kërkuara, siç janë punimet në Internet dhe Mobile Computing dhe IT Technician.

Përkrahur nga:



THE GOVERNMENT
OF THE GRAND DUCHY OF LUXEMBOURG